



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1916/3 Prot.

Tiranë, më 30.11. 2022

VENDIM

Nr. 99 dt. 30.11 2022

PËR

**HAPJEN E THIRRJES PËR VETËKANDIDIMIN E ANËTARIT STUDENT TË
KOMISIONIT TË KËRKIMIT, PROJEKTEVE DHE BOTIMEVE SHKENCORE NË
UST**

Në zbatim të nenit 38 pika 1 (gërma i), nenit 46 pika 3 dhe 6 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, nenit 20 (gërma nj) si dhe nenit 26 të Statutit të UST-së, Nenit 4 të Rregullores për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Përherëshëm, në Nivel Institucioni, për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Botimeve dhe Projekteve Shkencore, nenit 22, 23, 24 të Rregullores për Organizimin e Zgjedhjeve për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në UST, Senati Akademik në mbledhjen e datës 30.11.2022,

VENDOSI:

1. Hapjen e thirrjes për vetëkandidimin e anëtarit student për Komisionin e Kërkimit, Projekteve dhe Botimeve Shkencore (thirrja bashkëngjitur).
2. Vetëkandidimet të paraqiten në Zyrën e Protokoll-Arkivës dhe një kopje e tyre t'i përcillet Sekretarit të Senatit Akademik, Prof.Asoc. Robert Çitozi.
3. Ngarkohet për publikimin e këtij vendimi Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

NJOFTIM

Mbi vetëkandidimin për anëtarin student të Komisionit të Kërkimit, Projekteve dhe Botimeve Shkencore

Në zbatim të nenit 38 pika 1 (gërma i), nenit 46 pika 3 dhe 6 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, nenit 20 (gërma nj) si dhe nenit 26 të Statutit të UST-së, Nenit 4 të Rregullores për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Përhershëm, në Nivel Institucioni, për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Botimeve dhe Projekteve Shkencore, nenit 22, 23, 24 të Rregullores për Organizimin e Zgjedhjeve për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në UST,

Ftoheni të vetëkandidoheni për të qënë anëtarë të këtij komisioni, nëse plotësoni kriteret e përcaktuara në pikën 4 të nenit 22 të Rregullores për Organizimin e Zgjedhjeve për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në UST. Regjistrimi të bëhet në zyrën e Protokoll-Arkivës së UST-së, nga data 01.12.2022 brenda orës 15:30 të datës 07.12.2022.

Mbetemi në pritje të vetëkandidimeve tuaja, në mënyrë që në mbledhjen e radhës së Senatit Akademik, të përzgjidhet anëtari student, që do të jetë formojnë Komisionin e Kërkimit, Projekteve dhe Botimeve Shkencore në Universitetin e Sporteve të Tiranës.

Faleminderit për mirëkuptimin!

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.Dr. AGRON KASA

